



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 1133

NR. VENDIMI 1436

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE TEUTA HOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Adela Çinari në datën 27.02.2017 mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile me Nr.1133 Akti, që iu përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS *** me adresë në ***, përfaqësuar në gjykim me prokurë nga av. *** dhe Av. ***, me adresë ***.

I PADITUR ***, me adresë në *** përfaqësuar në gjykim me prokurë nga Av. ***.

2.Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave , me seli në Tiranë BLV Zhan D’ark , Shtepia e Ushtarakëve, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Av. ***, (në mungesë)

OBJEKTI Ndalimin e shkeljes së të drejtave të paditësit nga aplikimi i mëvonshëm për regjistrimi i markës ndërkombëtare IWATCH me Nr. *** në emër të të paditurit ***.

Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit Nr.8/6 datë 05.11.2005 të Bordit të Apelimit të DPPM, dhe refuzimin e aplikimit për regjistrimin e markës ndërkombëtare IWATCH me Nr. *** në emër të të paditurit, ***.

Baza ligjore Neni 137 (3) i Kodit të Procedurave Administrative (KPA); nenet 142, 143, 153 (4) 159, 174, 184/a e vijues të ligjit Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” (të ndryshuar) ;

Gjykata;

- si dëgjoi palën paditëse që gjatë gjykimit dhe në përfundim të tij kërkoi *pranimin e padisë*;
- Dëgjoi palën e paditur që gjatë gjykimit dhe në përfundim të tij kërkoi *rrëzimin e padisë*;
- Degjoi personin të tretë, por ne vijim e la gjykimin në mungesë;
- Administroi provat e paraqitura dhe si shqyrtoi në tërësi çështjen;

V Ë R E N

Paditësi në këtë gjykim Shoqëria *** është një shoqëri tregtare e cila kryen aktivitetin e saj në prodhimin e orëve dhe instrumentave kohëmatëse, përfshirë orët klasike, si dhe orë që përmbajnë teknologji. Paditësi është pronar i çertifikuar i disa markave tregtare "SWATCH" të regjistruara kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.

Më poshtë paraqiten disa nga regjistrimet ndërkombëtare të markave SWATCH të cilat gëzojnë mbrojtje në Shqipëri nëpërmjet Marrëveshjes dhe/ose Protokollit të Madridit.

Marka:

Numër Ndërkombëtar Regjistrimi:

IR ***

Data e Regjistrimit:

09.09.1986

Klasa:

14

Mallrat:

Metale të çmuara dhe aliazhet e tyre dhe mallra në metale të çmuara ose të veshura me to; stoli, gurë të çmuar; orë dhe instrumenta kronometrikë të tjerë.

Marka:

Numër Ndërkombëtar Regjistrimi:

IR ***

Data Ndërkombëtare e Regjistrimit:

09.10.1997

Klasa:

09

Mallrat:

Pajisje telekomunikacioni, transmetimi, marrje, regjistrimi dhe riprodhimi i informacionit të të gjitha llojeve të tilla si radio, telefona, televizorë.

3.

Marka:

SWATCH

Numër Ndërkombëtar Regjistrimi:

IR ***

Data Ndërkombëtare e Regjistrimit:

07.02.1997

Klasa:

14

4.

Marka:

Numër Ndërkombëtar Regjistrimi:

IR ***

Data Ndërkombëtare e Regjistrimit:

07.04.2008

Klasat:

14, 35, 37

Paditësi ka parashtruar se ka ardhur në në dijeni të publikimit të regjistrimit të markës ndërkombëtare IWATCH me numër regjistrimi IR*** të aplikuar fillimisht nga aplikanti ***, i cili u zëvendësua më vonë nga aplikanti *** (në vijim “****”), i paditur në këtë gjykim.

Marka IWATCH rezulton e publikuar në buletin e WIPO-s me numër dhe datë publikimi *** Gaz, datë 06.02.2014.

Në datën 26.05.2014 *** ka paraqitur në Bordin e Apelit të DPPM (në vijim “Bordi”) kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të kësaj marke për shkak të ngjashmërisë së lartë në klasat 09 dhe 14 me markat e tij “SWATCH” dhe “iSWATCH”.

Rezulton se *** e ka bazuar kundërshtimin në të drejtat e saj të mëparshme të fituara nga regjistrimi i mëhershëm i markave “SWATCH” dhe “iSWATCH” në raport me markën e kundërshtuar IWATCH, referuar në nenin 143(5) të Ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”.

Me vendimin nr. 8/6, datë 5.11.2015, Bordi i Apelit në DPPM ka vendosur:

1. Pranimin pjesërisht të kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar Nr. *** për markën IWATCH, për të gjitha mallrat e klasës 14;
2. Rrëzimin e kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar Nr. *** për markën IWATCH, për të gjitha mallrat e klasës 09.

Me padinë e ngritur paditësi pretendon se vendimi 8/6 i Bordit për pikën 2 është i pabazuar në ligj dhe duhet të shfuqizohet duke pretenduar se: Pala e paditur në mënyrë të gabuar arrin në konkluzionin se nuk ka mundësi për konfuzion apo bashkëlidhje midis markave SWATCH/iSWATCH dhe IWATCH dhe mallrave që ato përfaqësojnë; për arsyet e mëposhtme:

1. Ekziston ngjashmëri vizuale dhe fonetike midis markave

Bazuar në vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED) Sabel BV v. Puma AG, konsumatori mesatar normalisht e percepton markën si një të tërë dhe nuk ndalet të analizojë detaje të ndryshme të saj. Në rastin konkret, ngjashmëritë vizuale, fonetike dhe konceptuale të markave duhet të vlerësohen duke iu referuar përshtypjes së përgjithshme që markat krijojnë, duke patur parasysh elementët e tyre dominantë dhe dallues.

Në krahasimin midis markave iSWATCH dhe IWATCH, të dyja markat kanë të përbashkëta 6 gërma identike dhe të dyja markat fillojnë me gërmën “I”/ “i”, cka e bën ngjashmërinë vizuale midis markave të padiskutueshme.

Në krahasimin midis markave SWATCH dhe IWATCH, të dyja markat kanë të përbashkëta 5 gërma identike, të renditura njësoj te të dyja markat. Ndryshimet e vogla që qëndrojnë midis këtyre markave janë nga çdo këndvështrim të pamjaftueshme të shmangin ngjashmërinë vizuale.

2. Ekziston ngjashmëri fonetike midis markave.

Sipas palës paditëse Bordi bën një analizë të gabuar, pasi shqiptimin e markave SWATCH dhe iSWATCH e lidh me fjalën “iceWATCH”, fjalë kjo që nuk ka asnjë lidhje me shqiptimin e fjalës SWATCH.

3. Ekzistojnë ngjashmëria midis mallrave që përfaqësojnë markat.

Sipas palës paditëse të dyja markat përfaqësojnë mallra që përfshihen në të njëjtën klasë, por, sikurse vihet re nga krahasimi i listave respektive, të gjitha mallrat e klasës 9, që

përfaqësohen nga marka SWATCH, përfshihen tërësisht në listën e mallrave të klasës 9 që përfaqësohen nga marka IWATCH.

4. Ekziston mundësia për konfuzion tek publiku/konsumatorët përkatës.

Ndryshë nga sa arësyetën Bordi i DPPM se publiku përkatës përbëhet nga dy kategori, publiku i gjerë për mallrat e klasës 14 dhe ai profesional për mallrat e klasës 9, një ndarje e tillë nuk është e bazuar dhe i kundërvihet cdo literature në lidhje me publikun dhe mallrat.

Nga ana tjetër, mallrat e klasës 9 përfshijnë mallra si aparate radioje, telefona, aparate televizioni, etj, të cilat kanë drejtpërdrejt lidhje me dhe përdoren nga publiku i gjerë. Në këtë pikë, kjo ndarje mund të konsiderohet pa mëdyshje arbitrare dhe aspak ligjore. Rrjedhimisht nuk ekziston asnjë dallim midis përdoruesve dhe konsumatorëve të mallrave të klasës 14 dhe klasës 9, për të cilat janë regjistruar markat SWATCH/iSWATCH dhe për të cilat është aplikuar marka IWATCH.

5. Kemi të bëjmë me bashkëlidhje çorientuese.

Në internet ka një numër të madh artikujsh të vlefshëm, të cilët i përmendin së bashku Shoqëritë SWATCH dhe SWATCH Group, si dhe Shoqërinë ***. Markat iSWATCH/SWATCH dhe IWATCH janë gjithashtu të referuara së bashku në shumë artikuj në internet. Kjo bashkëlidhje sistematike sjell në një mundësi indirekte shkaktimin e konfuzionit dhe sygjeron përshtypjen e gabuar për një bashkëpunim të mundshëm ndërmjet këtyre Shoqërive, gjë që nuk është e vërtetë.

6. Kriter thelbësor i shkeljes është edhe Reputacioni i shoqërisë SWATCH dhe markës SWATCH

SWATCH është pjesë e Grupit SWATCH, shoqëria më e madhe dhe më dinamike në botë, e cila i ka prodhuar dhe shpërndarë produktet e saj me emrin e brandit SWATCH që në vitin 1983. Është kjo një kohë relativisht e gjatë, ku shoqëria SWATCH ka investuar në njohjen dhe reputacionin e markave të saj SWATCH.

7. Argumentimi i Bordit pranë DPPM se pjesa "I" e markës së kundërshtuar IWATCH është dalluese e markave Apple është i pabazuar pasi Gërma "I" përpara mjaft fjalëve është përshkruese dhe ka kuptimin e internetit; dhe, së dyti: kohët e fundit, Shoqëria *** e ka distancuar veten nga familja e markave të tyre fillestare që fillonin me gërmën "I", duke i emërtuar tashmë produktet e veta të fundit si APPLE WATCH, APPLE MUSIC, e kështu me radhë. Sipas palës paditëse asnjë subjekt, përfshi edhe Shoqërinë Apple, nuk mund të vendosë pozitën monopol mbi përdorimin e gërmës 'I' përpara markave të tyre.

Pala e paditur *** nëpërmjet përfaqësueses së tij ka kërkuar rrëzimin e padisë për sa më poshtë:

Në të kundërt nga sa pretendon paditesi, bashkëekzistenca e markave në diskutim NUK shkakton Mundësi për Konfuzion [143(2)(b) i ligjit].

Paditesi nuk provoi dot përdorimin e markave të tij për mallra të klasës 9 kështu që automatikisht padia duhet të rrëzohet dhe sikur të ekzistonte mundësia për konfuzion [173 (3) i ligjit]

Padia është parashkuar si e ngritur tej afatit ligjor.

Për të gjitha pretendimet e mësipërme pala e paditur *** paraqiti prapësime të detajuara, duke mbështetur qëndrimin e mbajtur nga Bordi i Apelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave.

Gykata

në analizë të pretendimeve të palëve dhe provave të paraqitura çmon si më poshtë:

Lidhur me natyrën e çështjes dhe kompetencën:
Padia e ngritur nga pala paditëse përbën një nga paditë për mbrojtjen e posaçme të të drejtave të pronësisë industriale sipas ligjit specifik Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.

Në nenin Neni 153 të ligjit nr.9947/2008 parashikohet shprehimisht se:

4. Vendimi i bordit të apelimit për kundërshtimin e paraqitur në bazë të nenit 152 të këtij ligji, mund të apelohe në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bordit
Neni 184

Procedurat kundër shkeljes së të drejtave

1. Aplikanti dhe përdoruesi i regjistruar i një treguesi gjeografik mund të ngrenë padi në gjykatë për shkeljen e të drejtave.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: Gjykatë" është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Neni 348 i K.Pr. Civile përcakton shprehimisht se: “ Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe shërbimit, dizenjot, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëvshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipa srregullave të përcaktuar në këtë Kod”.

Padia e paraqitur për shqyrtim fillimisht është depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. *** datë *** ka vendosur :

“Të shpallë moskompetencën e lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vlerëson se padia për shqyrtim është në kompetencën e saj lëndore dhe territoriale. Ligji i posaçëm Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” në disa dispozita të tij ka përcaktuar si Gjykatë kompetente për paditë që ngrihen në kuadrin e të drejtave të rregulluara nga ky ligj është pikërisht Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Nga ana tjetër edhe Kodi i Procedurës Civile në nenin 348 të tij ka përcaktuar shprehimisht se mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe shërbimit, dizenjot, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëvshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të përcaktuar në këtë Kod.

Gjykata vë në vemendje se :fakti se objekti gjykimit është kundërshtimi i vendimit të Bordit të Apelimit nuk nënkupton se padia e ngritur është një nga paditë që janë në kompetencë të Gjykatës Administrative. Thelbi i të drejtave në konflikt përbëhet nga të drejtat e pronësisë industriale që pretendon se zotëron pala paditëse dhe që çënohen eventualisht nga pretendimi për zotërim i këtyre të drejtave nga aplikanti, i padituri në këtë proces. Pra, në këtë rast mosmarrëveshja konsiston në përcaktimin e të drejtave të pronësisë së një lloji të posaçëm , pikërisht pronësisë industriale.

Në këtë këndvështrim Bordi i Apelimit nëpërmjet vendimit të tij mban një qëndrim për të certifikuar nëpërmjet regjistrimit të drejtat e pronësisë industriale që zotërohen nga aplikantët.

Në këtë këndvështrim vendimet e Bordit të Apelimit nuk krijojnë në vetvete të drejta pronësie për palët pjesmarrëse, por legjitimojnë aplikimet për regjistrimin ose jo të të drejtave të pronësisë të subjekteve të procedurës.

Sa më lart zhvendosja e konfliktit në gjykatë ndonëse në aspektin formal konsiston edhe kundërshtim të vendimit të Bordit të Apelimit , por hetimi dhe gjykimi në thelb ka të bëjëvme vlerësimin mbrojtjes ligjore të të drejtave të pronësisë industriale të palëve . Pra në këtë rast gjykimi bazohet në hetimin dhe verifikimin e të drejtave të pronësisë industriale

të secilës palë, verifikimin e ekzistencës së elementëve të veçantë dhe të përbashkët dhe peshën e tyre në raport me të drejtën e pronësisë në tërësi që zotëron secila palë. Për rrjedhojë, bazuar në sa më lart, jo vetëm për shkak se si ligji i posaçëm “Për Pronësinë Industriale”, ashtu edhe neni 348 i K.Pr Civile kanë përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, por edhe për shkak se thelbi i konfliktit konsiston në mbrojtjen e pronësisë, konkludohet se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente për shqyrtimin e kësaj padie.

Lidhur me themelin e pretendimeve

Neni 143 (2) (b) i ligjit specifik parashikon të drejtën e pronarit të një marke të mëparshme të kundërshtojë, midis të tjerash, një aplikim të mëvonshëm i cili për shkak të ngjashmërive me markën e mëparshme mund të shkaktojë konfuzion.

Konkretisht, dispozita në diskutim parashikon shprehimisht: “2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur, b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike apo të ngjashme dhe kur, për shkak të njëlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakimit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet dhe mundësia e bashkëlidhjes së markës.”

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, regjistrimi i një marke në kundërshtim me kriteret e mësipërme kundërshtohet për pavlefshmëri në Gjykatë dhe padia i kundërshtohet palës në favor të të cilës është regjistruar formalisht marka, dhe shkak i pavlefshmërisë ka të bëjë me cënimin e të drejtave të mëparshme të pronësisë industriale. Në këtë kuptim padia për shqyrtim në ne objektin e saj përfshin pikërisht këtë nocion ligjor dhe në këtë këndvështrim plotëson kushtin e legjitimit pasiv në tërësi.

Nga interpretimi i nenit 143/2/ b të ligjit konkludohet se mundësia për konfuzion ekziston kur të dy kushtet përmbushen njëkohësisht: (1) ngjashmëri mes shenjave, duke mbajtur parasysh karakterin dallues dhe dominant të tyre; (2) ngjashmëri mes mallrave/shërbimeve.

Në funksion të kryerjes së një vlerësimi gjithëpërfshirës të mundësisë për konfuzion, gjykata çmon të analizohen :

Shkalla e ngjashmërive midis mallrave/shërbimeve dhe shenjave/markave, p.sh nëse ngjashmëria e mallrave/shërbimeve nuk është e evidente apo mallrat janë shumë pak të ngjashëm nuk ka gjasa për konfuzion.

Publiku përkatës dhe shkalla e vëmëndjes së tij, ku një shkallë e lartë vëmëndje e konsumatorëve minimizon mundësinë për konfuzion, pasi konsumatori në këtë rast do të jetë më i vëmëndshëm e do të memorizojë dhe differencat mes markave, apo anasjelltas;

Njohja e markave në treg, reputacioni dhe fuqia tërheqëse e tyre. Komponenti më i rëndësishëm i këtij elementi është karakteri dallues i markave në diskutim, ku ngjashmëritë përkojnë në karakterin dallues atëherë mundësia për konfuzion është më shumë se e evidente. Asociimi që mund ti bëhet markës së kundërshtuar me markën kundërshtuese. Ky element ka të bëjë me mundësinë e bashkëlidhjes së markës – koncept ky ligjor që është pjesë e mundësisë për konfuzion, dhe ka të bëjë me rastin kur konsumatorët u artibulojnë markave të njëjtën origjinë tregare, dmth pronari i markës së kundërshtuar mund të perceptohet si i licensuari/distributor i pronarit të markave kundërshtuese, apo mund të perceptohet si degë e kompanisë (mëmë) të pronarit të markave kundërshtuese apo anasjelltas.

Gjykata vlerëson se në rastin në diskutim, (i) nuk kemi ngjashmëri mes mallrave pasi mallrat janë të ndryshëm ose shumë pak të ngjashëm ;(ii) shenjat përkojnë në elementë të dobët të tyre – fjala e përbashkët “WATCH” nuk është e mjaftueshëm për t’i bërë markat e ngjashme; (iii) pajisjet elektronike janë një tipar esencial i markës së të paditurit ***që

gëzon reputacion në mallrat në diskutim – pajisjet elektronike; (v)një tjetër faktor që shmag tërësisht mundësinë e supozuar për konfuzion është dhe shkalla e vemendjes së konsumatori në rastin e markave të kompanisë *** është shumë e lartë.

Të gjithë këta faktorë janë të mjaftueshëm për të përjashtuar çdo mundësi për konfuzion. Objekti këtij gjykimi janë vetëm mallrat e klasës 9 pasi kjo është pjesa e vendimit të Bordit të Apelimeve që paditësi kundërshton në këtë proces. Pra ndërsa aplikimi i palës së paditur ka qenë për mallrat e klasës 9 dhe 14, kundërshtimi paditësit është pranuar për mallrat e klasës 14. Rezulton se vetëm një (1) nga katër (4) markat e SWATCH figuron e regjistruar në mallrat e klasës 9 .

Mallrat e këtyre klasave (9 dhe 14) janë të ndryshme dhe markat që nuk janë të regjistruara në klasën 9 automatikisht përjashtohen nga krahasimi (pasi nuk plotësohet kushti ligjor i ngjashmërive mes mallrave).

Për pasojë markat objekt gjykimi janë si më poshtë:

IWATCH

Nr. *** – marka kundërshtuese Nr. *** – aplikimi i kundërshtuar .

Gjykata vlerëson se mallrat konsiderohen të njëjta apo identike kur (i) mallrat/shërbimet koincidojnë në emërtim, apo janë sinonime të njera-tjetrës, ose (ii) mallrat/shërbimet përfshihen në kategorinë e njera-tjetrës. Kurse për sa i përket ngjashmërisë mallrat janë të ngjashëm kur ato ndajnë karakteristika të përbashkëta lidhur kryesisht me natyrën e tyre, qëllimin, metodën e përdorimit, dhe nëse ato janë në konkurrencë me njera-tjetrën apo janë plotësuese të njera-tjetrës. Të tjerë faktorë ,përfshijnë mënyrat e shpërndarjes sidomos ato të dyqaneve të shitjes, publikun përkatës dhe origjinën e zakonshme të mallrave.

Në rastin konkret, ashtu sic rezulton, mallrat objekt krahasimi janë ato të klasës 9, të cilat janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Krahasimi i listës së mallrave të markave në diskutim

Marka kundërshtuese Nr. ***

Marka e kundërshtuar Nr. ***

Klasa 9 – Aparate telekomunikimi, transmetimi, marrje, regjistrimi dhe riprodhimi i informacionit të çdo lloji, psh. aparate radioje, telefoni, aparate televizioni.

Klasa 9– Softëare kompjuteri; pajisje sigurie; konkretisht alarme kundër vjedhjeve, pajisje elektronike kundër vjedhjes dhe aparate alarmi si dhe siguresa kontrolli, zbulimi dhe parandalimi; monitorë (hardëare kompjuterike); pajisje kontrolli; elektronike; pajisje xhiruese dhe për shkrepjen e fotografive; kompjutera; hardëare kompjuteri; periferiale kompjuterike; pajisje komunikimi pa tel (ëirteless); radio; pajisje audio dhe video, pajisje për sisteme pozicionimi globale; aksesorë; pajisje, përbërës dhe kuti për të gjitha mallrat e sipërpëmendura.

Nga një krahasim i kujdeshëm konstatohen lehtësisht se mallrat e klasës 9 janë të ngjashëm vetëm për “pajisje xhiruese dhe për shkrepjen e fotografive”; dhe “radio; pajisje audio dhe video” të cilat mund të jenë të ngjashme me segmentin vijues “regjistrimi dhe riprodhimi i informacionit të cdo lloji, psh. aparate radioje, telefoni, aparate televizioni” të markës kundërshtuese.

Pjesa tjetër e listës së mallrave të markës së kundërshtuar është e ndryshme. Fakti se këto mallra i përkasin të njëjtës klasë – ashtu sic paditësi përpiqet të argumentojë, nuk përbën shkak në vetvete për t’i konsideruar mallrat identike, apo të ngjashme. Ato as nuk janë në konkurrencë me njëra-tjetrën dhe as nuk janë plotësuese të njëra-tjetrës, psh “pajisje sigurie”, me “aparate transemitimi, etj, nuk kanë asnjë lidhje.

Përveç krahasimit analitik të mësipërme konstatohet një listë e gjerë e mallrave të markës së kundërshtuar të listuara në këtë klasë, në tërësinë e saj e ndryshme nga lista e mallrave të markës kundërshtuese si dhe nga prania e një elementi dallues siç janë softëare, hardëare kompjuterikë.

Për këto arsye konkludohet se mallrat në diskutim janë të ndryshëm dhe vetëm në segmente të caktuara dhe joesenciale ato mund të jenë disi të ngjashme.

Në aspektin vizual ka një ndryshim në paraqitjen formale të markave ku shkrimi i aplikuar për markën SWATCH është një lloj i posaçëm shkrimi me shkronja të rumbullakosura lloj shkrimi ky që në rastin konkret përbën edhe një element të identitetit të kësaj marke. Ndërsa për markën e kundërshtuar shkrimi që nënkupton aspektin vizual nuk përfaqëson ndonjë element identiteti. Pra, në aspektin vizual markat nuk konsiderohen të njëjta. Është e vertetë që ngjashmëritë mes markave përkojnë në fjalën WATCH, por ky term është një fjalë e përgjithshme kështu që ngjashmëritë në elementë përshkrues të markave (quajtur ndryshe, elementë të dobët) nuk sjellin ndonjë ngjashmëri në marka dhe si pasojë nuk ekzistojnë premisa për konfuzion.

Sa i përket fonetikut, ndonëse markat kanë elementin e përbashkët atë “WATCH” që nënkupton veprimin njërëzor të të parit, këqyrjes, vështrimit, shquarjes, ky element në të dy rastet ka karakter përshkrues të këtij akti dhe si i tillë nuk përbën karakter dallues. Termat fonetikë të përbashkët “WATCH” të dy markave në këtë rast konsistojnë një përdorimin e zakonshëm dhe masiv të kësaj fjale jetën e përditshme, po ashtu edhe me vetë simbolin e veprimit njërëzor korrespondues, dhe në këtë këndvështrim përfaqëson një nevojë të konsumatorit për përdorimin e një fjale që jo domosdoshmërisht lidhet me një markë të caktuar.

Por nga ana tjetër, ndërsa shqiptimi i fjalës SWATCH bëhet në një rrokje të vetme, shqiptimi i markes “I WATCH” përbëhet nga dy rrokje (AJ) dhe (Uoç). Pra, edhe fonetikut markat nuk konsiderohen të njëjta.

Për sa i përket ngjashmërive të tjera të pretenduara në shenja – vizuale, fonetike, konceptuale, gjykata gjen të mbështetur qëndrimin e Bordit. Prefiksi “i” i markës së kundërshtuar është një nga karakteret dallues të markave Apple. Shkronja "i" e shkruar me gërmë të vogël, e ndjekur nga një fjalë që fillon me shkronjë të madhe ka konsoliduar perceptimin tek publiku se marka me prefiks “i” është sinonim i produkteve të Apple. Apple e ka krijuar familjen e tij të markave - prefiksi “i” prej 1998 me produktet e tij të konsideruara gjerësisht novatore si psh. kompjutera iMac dhe iBook, e ndjekur nga iMovie. Konsumatorët lehtësisht e identifikojnë sinjalin e markave Apple – prefiksi “i”, pasi produktet që mbajnë këto shenja janë në duart e miliona konsumatorëve.”

Në këto kushte WATCH ndonëse është element i përbashkët i këtyre dy markave është tërësisht periferik dhe mund të thuhet se, karakteri dallues i markave qëndron tek prefiksi i tyre IWATCH vs. SWATCH, dhe krahasimi nuk mund të fokusohet tek këta të fundit. Markat janë të ndryshme nga pikëpamja konceptuale, dhe jo siç pretendon *** se markat në

diskutim nuk kanë ndonjë kuptim, dhe si pasojë krahasimi konceptual nuk ka asnjë rëndësi.

Disa mallra konsiderohen si konceptualisht të njëjta apo të ngjashme kur ato përcjellin kuptime të njëjta apo të ngjashme. Markat janë të ndryshme konceptualisht kur secila prej tyre përcjell kuptime të ndryshme, apo kur njëra prej tyre përcjell një kuptim dhe tjetra jo. Në rastin konkret, marka IWATCH mund të perceptohet si “unë shikoj” ndërsa marka “sWATCH” apo “i SWATCH” nuk përcjell asnjë kuptim të caktuar. Kështu që jemi para një rasti kur njëra nga markat përcjell një kuptim të caktuar, kurse tjetra jo.

Në këto kushte konkludohet se ndodhemi para dy markave konceptualisht të ndryshme, që përjashton mundësinë për konfuzion.

Në vlerësimin e mundësisë për konfuzion duhet mbajtur parasysh edhe shkalla e vëmendjes së konsumatorit mesatar e cila mund të ndryshojë në varësi të mallrave dhe shërbimeve që markat mbulojnë. Në qoftë se ka një nivel të lartë vëmendje, ndryshimet midis markave do të vihen re dhe kjo do të minimizonte mundësitë për konfuzion, pasi konsumatori për shkak të vëmendjes do të diferenconte markat, apo anasjelltas

Në rastin konkret ekzistojnë disa arsye për të konkluduar se shkalla e vëmendjes së konsumatorit është e lartë lidhur me mallrat e markës IWATCH. Kjo pasi, mallrat në diskutim janë mallra që nuk blihen shpesh, si dhe janë relativisht të kushtueshme. Këto fakte në vetvetë përbëjnë bazë të mjaftueshme për të konkluduar se bjerja e tyre imponon një shkallë të lartë vëmendjeje. Për më tepër publiku përkatës është përgjithësisht i mirëinformuar ose i specializuar. Mallrat në diskutim, kryesisht pajisje elektrike/elektronike që janë pajisje që blihen dhe përdoren nga konsumatorë me përvojë në këtë fushë apo profesionistë, të cilët për shkak të aftësive të tyre njohëse i kushtojnë rëndësi blerjes së këtyre pajisjeve, e për pasojë prezumohet se evidentojnë dhe diferencat mes markave, pa i konfunduar.

*** është një nga dizenjatorët, prodhuesit dhe shitësit e telefonave celularë, kompjutereve personale, produkteve të ndryshme elektrike, si dhe ofrues i shërbimeve të riparimit të këtyre produkteve i mjaft i njohur ndërkombëtarisht veçanërisht në dekadën e fundit nëpërmjet hedhjes në treg të si iPod, iPhone, iPad, I Mac etj duke krijuar krijuar familjen e tij të markave - me elementin dallues, prefiksin “i”, dhe për këto pala e paditur ka paraqitur një listë të tyre e përkatësisht :IMAC – Gusht 1998, IBOOK – Korrik 1999, IBOOK – Tetor 1999, IDVD – Janar 2001, ITUNES – Janar 2001, IPOD – Tetor 2001, IPHOTO – Janar 2002, ICALL – Korrik 2002, ISYNC – Korrik 2002, ILIFE – Janar 2003, ICHAT – Qershor 2003, ISIGHT – Qershor 2003, IWORK – Janar 2005, IWEB – Janar 2006, IPHONE – Qershor 2007, IPAD – Qershor 2010, IBOOKS – Janar 2010 IBOOKSTORE – Janar 2010, IAD – Prill 2010, IOS – Qershor 2010, ICLOUD – Qershor 2011, IMESSAGE – Qershor 2011, IBEACON – Dhjetor 2013.

Ndodhur para këtyre fakteve gjykata vlerëson se prefiksi “i” tek marka e kundërshtuar përbën një nga karakteret dallues të markave Apple. Shkronja “i” e shkruar me gërmë të vogël, e ndjekur nga një fjalë që fillon me shkronjë të madhe ka konsoliduar perceptimin tek publiku se marka me prefiksin “i” është sinonim i produkteve të *** dhe konsumatorët e zakonshëm apo mesatarë lehtësisht e identifikojnë këtë fakt

Paditësi i referohet statusit të tij si mbajtës i markave të mirënjohura, por në këte proces diskutohet vetëm mallrat e klasës 9 – pajisjet elektronike dhe pala paditëse nuk provoi në këtë gjykim me prova sipas përkufizimit të Kodit Procedurës Civile faktin se marka SWATCH është e mirënjohur në vëndin tonë për këto lloj paisjesh.

Prapësimi i palës së paditur se padia është ngritur tej afatit ligjor, është tërësisht i pabazuar, pasi nëpërmjet provave të paraqitura rezultoi se padia e ngritur nga pala paditëse është depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda afatit 30 ditor nga dita e marrjes dijeni të përfaqësuesve të kësaj pale. Sa më lart, ky prapësim mbetet i parëndësishëm në zgjidhjen e çështjes.

PËR KËTO ARSYE
Konform neneve 126 dhe 305 e vijues të K.Pr.Civile; Gjykata;

VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesë-padisë.
- Shpenzimet gjyqësore proceduriale i ngarkohen palës paditese.
- Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e shpalljes. Për palën e paditur DPPM në mungesë afati fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.
- **U shpall në Tiranë më 27.02.2017.**

SEKRETARE

Adela Çinari

GJYQTARE

Teuta HOXHA

Shpenzime gjyqësore
Taksë regj. padie 3.000 Lekë
Avokat (pala paditese)1488 Euro